



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KOMISIONERËT PUBLIKË

Nr. 439/7 prot.

Tiranë, 15.11.2018

- Lënda:** Ankim i Komisionerit Publik kundër vendimit nr. 61, datë 2.8.2018, të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, për subjektin e rivlerësimit z. Gentjan Osmani
- Baza ligjore:** Neni 179/b, pika 5 e Kushtetutës, neni C, pika 2, neni F, pika 2 e aneksit të Kushtetutës, neni 63 i ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”
- Për kompetencë:** Kolegjit të Posaçëm të Apelit, pranë Gjykatës Kushtetuese
- Për dijëni:** Operacionit Ndërkombëtar të Monitorimit
- Depozituar pranë:** Komisionit të Pavarur të Kualifikimit

Të nderuar zonja/zotërinj, gjyqtarë të Kolegjit të Posaçëm të Apelit, pranë Gjykatës Kushtetuese,

Në zbatim të nenit 55, pika 7 e ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, pranë Institucionit të Komisionerëve Publikë, më datë 31.10.2018, është njoftuar vendimi nr. 61, datë 2.8.2018, i Komisionit të Pavarur të Kualifikimit për subjektin në rivlerësim z. Gentjan Osmani, Prokuror në Prokurorinë pranë Gjykatës së Parë për Krime të Rënda Tiranë.

Ndaj këtij vendimi, në zbatim të nenit B, pika 3, germa “c” e aneksit të Kushtetutës dhe nenit 65, pika 2 e ligjit nr. 84/2016, pranë Institucionit të Komisionerëve Publikë, më datë 9.8.2018, është depozituar akti “*Rekomandim për paraqitje ankimi*” me nr. 1101 prot., nënshkruar nga tre vëzhgues të Operacionit Ndërkombëtar të Monitorimit (ONM).

Komisioneri Publik, në mbështetje të nenit C, pika 2, nenit F, pika 2 e aneksit të Kushtetutës dhe nenit 63, pika 1 e ligjit nr. 84/2016, ka të drejtë të ankimojë vendimin brenda afatit 15-ditor nga njoftimi.

Brenda afati ligjor, unë, Komisioneri Publik Darjel Sina, ushtroj ankim ndaj vendimit nr. 61, datë 2.8.2018, të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit.

I. Procesi i rivlerësimit dhe përfundimet e Komisionit të Pavarur të Kualifikimit

1. Subjekti i rivlerësimit, z. Gentjan Osmani, ushtron funksionin e Prokurorit në Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë për Krime të Rënda Tiranë dhe, duke qenë kandidat për anëtar i Këshillit të Lartë të Prokurorisë,¹ i është nënshtruar procesit të rivlerësimit *ex officio* me përparësi, bazuar në nenin 179/b, pika 3 e Kushtetutës.
2. Mbështetur në nenin Ç, pika 1 e aneksit të Kushtetutës dhe ligjit nr. 84/2016, procesi i rivlerësimit ndaj z. Gentjan Osmani ka përfshirë kontrollin dhe rivlerësimin e të tria kriterëve, atë të pasurisë, figurës dhe aftësive profesionale. Për këtë qëllim, Komisioni i Pavarur të Kualifikimit (në vijim referuar si Komisioni) ka administruar raportet e vlerësimit të hartuara për këtë subjekt nga institucionet ndihmëse, Inspektorati i Lartë i Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive dhe Konfliktit të Interesave (në vijim referuar si ILDKPKI), raportin e vlerësimit të figurës nga Drejtoria e Sigurimit të Informacionit të Klasifikuar (në vijim referuar si DSIK) dhe raportin e vlerësimit profesional nga grupi i punës pranë Prokurorisë së Përgjithshme, nga të cilat rezulton se:
 - 2.1 ILDKPKI, bazuar në nenin 33, pika 5 e ligjit nr. 84/2016, me anë të “*Aktit të përfundimit të kontrollit të plotë të deklaratës së pasurisë së subjektit Gentjan Osmani*”², ka referuar se:
 - i. *Deklarimi është i saktë në përputhje me ligjin;*
 - ii. *Ka burime financiare të ligjshme për të justifikuar pasuritë;*
 - iii. *Nuk ka kryer fshehje të pasurisë;*
 - iv. *Nuk ka kryer deklaram të rremë;*
 - v. *Subjekti nuk gjendet në situatën e konfliktit të interesave.*
 - 2.2 DSIK, bazuar në nenin 39, pika 2 e ligjit nr. 84/2016, me anë të raportit mbi kontrollin e figurës për subjektin³, ka referuar “*Përshtatshmërinë për vazhdimin e detyrës*”.
 - 2.3 Grupi i punës pranë Prokurorisë së Përgjithshme, bazuar në nenin 43, pika 2, të ligjit nr. 84/2016, në përfundim të rishikimit të dokumenteve ligjore të përpiluara nga subjekti gjatë periudhës objekt i rivlerësimit, si dhe 5 dokumenteve të tjera ligjore të përzgjedhura sipas një sistemi objektiv dhe rastësor, ka përcjellë pranë Komisionit⁴ raportin e hartuar për analizimin e aftësive profesionale të subjektit.
3. Komisioni pas hetimit administrativ mbi faktet dhe rrethanat lidhur me kontrollin e pasurisë, figurës dhe aftësive profesionale të subjektit të rivlerësimit, në mënyrë të përmbledhur, për secilin kriter, ka vlerësuar dhe arritur në përfundimet si vijon:
 - 3.1 **Për vlerësimin e pasurisë**, bazuar në nenin D të aneksit të Kushtetutës dhe kreun IV të ligjit nr. 84/2016, hetimi administrativ i Komisionit ka konsistuar në kontrollin dhe vlerësimin e saktësisë, mjaftueshmërisë së deklaramit dhe burimin e ligjshëm të pasurive dhe të të ardhurave të subjektit të rivlerësimit dhe personave të lidhur me të. Nga ky hetim ka rezultuar se provat dhe faktet e dala kanë nivelin e provueshmërisë referuar nenin 45 të ligjit nr. 84/2016, shkak për të cilin subjektit të rivlerësimit⁵ i ka kaluar barra e provës në bazë të

¹ Referuar nenin 279 të ligjit nr. 115/2016, “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”, të ndryshuar.

² Protokolluar pranë Komisionit me nr. *** prot., datë ***.11.2017.

³ Protokolluar pranë Komisionit me nr. *** prot., datë ***.11.2017.

⁴ Shkresa e Prokurorisë së Përgjithshme, nr. *** prot., datë ***.1.2018.

⁵ Me anë të vendimit nr. ***, datë ***.7.2018, të trupës gjyquese të Komisionit. Referuar *email*-it dërguar subjektit të rivlerësimit më datë ***.7.2018.

nenit D, pika 5 e aneksit të Kushtetutës dhe nenit 52 të ligjit nr. 84/2016, për çështjet si vijon:

3.1.1 Personi tjetër i lidhur, z. ***. ***, i deklaruar në cilësinë e huadhënësit, nuk ka pasur të ardhura të mjaftueshme për të justifikuar/dhënë huan në shumën 20.000 euro. Hua e deklaruar nga subjekti si burim krijimi pasurie/apartament në 2009.

3.1.2 Vërtetimi i burimit të ligjshëm, mënyra e posedimit dhe kalimi i shumës së dhuruar prej 1.500.000 lekë nga personat e tjerë të lidhur, prindërit e bashkëshortes së subjektit të rivlerësimit. Dhurim i deklaruar nga subjekti si burim krijimi i së njëjtës pasuri/apartament në 2009.

3.1.3 Për sa i përket shlyerjes së apartamentit në vitin 2009, përkatësisht shlyerja e dy kësteve, 15.000 euro, në datë ***.1.2009 dhe 32.680 euro, në datë ***.3.2009, nga analiza financiare (përfshirë edhe huaja) subjekti rezulton me mungesë të burimeve të ligjshme në shumën 1.043.092 lekë.

3.1.4 Nga analiza financiare për vitin 2005, subjekti rezulton me mungesë të burimeve të ligjshme në shumën 235.761 lekë për blerjen e automjetit dhe shpenzimeve të tjera të kryera, fakt i cili ngre dyshime për mosdeklarimin e këtij aset në vitin përkatës 2005, por në vitin 2009.

3.1.5 Nga analiza financiare për vitin 2011, subjekti rezulton me mungesë të burimeve të ligjshme për shlyerjen e huas në shumën 7.000 euro, kursimet e krijuara dhe shpenzimet e vitit, me balancë negative në shumën 1.250.615 lekë.

3.1.6 Nga analiza financiare për vitin 2012, subjekti rezulton me mungesë të burimeve të ligjshme për shlyerjen e huas në shumën 5.000 euro, kursimet e krijuara dhe shpenzimet e vitit, me balancë negative në shumën 112.169 lekë.

3.1.7 Nga analiza financiare për vitin 2013, subjekti rezulton me mungesë të burimeve të ligjshme për shlyerjen e huas në shumën 8.000 euro, kursimet e krijuara dhe shpenzimet e vitit, me balancë negative në shumën 1.136.135 lekë.

3.1.8 Sa më sipër, nga analiza financiare për vitet 2005, 2009, 2011, 2012 dhe 2013, subjekti ka rezultuar me mungesë të burimeve të ligjshme në total për shumën 3.777.773 lekë.

3.2 Komisioni, pas administrimit dhe vlerësimit të provave dhe shpjegimeve të subjektit të rivlerësimit për të provuar të kundërtën e rezultateve të hetimit, në përfundim ka konkluduar se *“...Deklarimi në deklaratën “Vetting” është i saktë dhe në përputhje me ligjin. Pasaktësitë e konstatuara në deklaratimet ndër vite nuk kanë sjellë pasoja të tilla që ato të konsiderohen të pamjaftueshme në kuptim të nenit 61/3, të ligjit nr. 84/2016. Nuk ka mungesë të burimeve të ligjshme financiare për të justifikuar pasuritë. Nuk është kryer fshehje pasurie. Nuk ka deklarime të rreme. Subjekti nuk ndodhet në situatën e konfliktit të interesit”*.

3.3 **Për kontrollin e figurës**, bazuar në nenin DH të aneksit të Kushtetutës dhe kreun V të ligjit nr. 84/2016, nga hetimi administrativ i Komisionit nuk është gjetur asnjë element që të vërtetojë përfshirjen e mundshme të subjektit të rivlerësimit në veprime korruptive për shkak funksioni apo ekzistencën e kontakteve të papërshtatshme. Subjekti është gjendur në kushtet e përshtatshmërisë për vazhdimin e detyrës.

3.4 **Për vlerësimin e aftësive profesionale**, Komisioni bazuar në nenin E të aneksit të Kushtetutës dhe kreun VI të ligjit nr. 84/2016, pas administrimit dhe analizimit të raportit të përgatitur nga grupi i punës pranë Prokurorisë së Përgjithshme, vlerësimit të 2 denoncimeve

nga publiku, nuk ka gjetur indicie apo elemente që mund të ngrenë dyshime për paaftësi profesionale apo cilësi që cenojnë figurën e Prokurorit. Subjekti i rivlerësimit, z. Gentjan Osmani, ka arritur një nivel të lartë të vlerësimit të aftësive profesionale.

4. Nisur nga përfundimet e mësipërme për secilin kriter vlerësimi, bazuar në nenin 58, pika 1, germa "a", dhe nenin 59, pika 1 e ligjit nr. 84/2016, Komisioni ka vendosur konfirmimin në detyrë të subjektit të rivlerësimit z. Gentjan Osmani, me funksion Prokuror në Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë për Krime të Rënda Tiranë.

II. Shkaqet e ankimit

5. Në kuptim të nenit 179/b të Kushtetutës, aneksit të Kushtetutës dhe ligjit nr. 84/2016, "Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë", Komisioneri Publik është një nga tri institucionet që kryejnë procesin e rivlerësimit kalimtar (Vetting).
6. Komisioneri Publik, si përfaqësuesi i interesit publik në kryerjen e këtij procesi, i njihet e drejta e ankimit kundër vendimeve të Komisionit dhe paraqitjen e tyre juridiksionit rivlerësues të Kolegjit të Posaçëm të Apelimit (në vijim referuar si Kolegji).
7. Në krahasim me kompetencat kushtetuese dhe ligjore që u njihen Komisionit dhe Kolegjit nga neni Ç i aneksit të Kushtetutës, nenet 48 - 52 të ligjit nr. 84/2016, Komisioneri Publik është i detyruar që kompetencën e tij për të ushtruar ankim ndaj vendimeve të Komisionit, ta mbështesë vetëm në aktet dhe provat e administruara gjatë kryerjes së procesit të rivlerësimit nga ana e këtij të fundit, pa pasur mundësinë ai vetë (Komisioneri), që të ketë akses në burimet e informacionit dhe të disponojë për marrjen e provave.
8. Në të tilla rrethana ligjore, me qëllim garantimin e mbrojtjes së interesit publik gjatë procesit të rivlerësimit, Komisioneri Publik ka detyrimin që të ushtrojë kontroll mbi vendimet e dhëna nga Komisioni, duke vlerësuar nëse vendimmarrja e tij është në përputhje me kërkesat kushtetuese e ligjore, bazohet në një hetim administrativ të gjithanshëm e shterues dhe vlerësim të drejtë të provave.
9. Edhe në rastin konkret, Komisioneri Publik, mbështetur në kompetencën e tij kushtetuese dhe ligjore, nga shqyrtimi i vendimit nr. 61, datë 2.8.2018, dhe provave të administruara për këtë qëllim nga Komisioni, në konsideratë edhe të rekomandimit të ONM-së (bashkëlidhur këtij ankimi), vlerëson se vendimi përmban shkaqe ligjore që motivojnë rishikimin nga ana e Kolegjit të Posaçëm të Apelimit.
10. Nisur nga rezultatet e hetimit dhe vlerësimit të Komisionit, Komisioneri Publik konstaton se përfundimet nuk janë në pajtueshmëri me aktet dhe provat e administruara. Në identifikimin e shkaqeve të ankimit, Komisioneri Publik mban në konsideratë mbrojtjen e interesit publik dhe paraqitja e tyre juridiksionit rivlerësues pranë Kolegjit të Posaçëm të Apelimit bëhet me qëllim që procedura e rivlerësimit kalimtar për subjektet e rivlerësimit të kryhet në mënyrë të plotë dhe të gjithanshme mbi bazën e përcaktimeve kushtetuese e ligjore për secilin kriter kontrolli.
11. Referuar nenit 179/b, pika 1 e Kushtetutës, sistemi i rivlerësimit është ngritur me qëllim që të garantohet funksioni i shtetit të së drejtës, pavarësia e sistemit të drejtësisë, si edhe të rikthehet besimi i publikut tek institucionet e këtij sistemi.

12. Sipas nenit D, pika 3 e aneksit të Kushtetutës, “Subjekti i rivlerësimit duhet të shpjegojë bindshëm burimin e ligjshëm të pasurive dhe të të ardhurave. Pasuri të ligjshme për qëllimet e këtij ligji konsiderohen të ardhurat që janë deklaruar dhe për të cilat janë paguar detyrimet tatimore. Elemente të tjera të pasurisë së ligjshme përcaktohen me ligj”. Ndërsa pika 5 e kësaj dispozite përcakton se: “Nëse subjekti i rivlerësimit përpiqet të fshehë ose të paraqesë në mënyrë të pasaktë pasuritë në pronësi, posedim ose në përdorim të tij, zbatohet parimi i prezumimit në favor të masës disiplinore të shkarkimit dhe subjekti ka detyrimin të provojë të kundërtën”.
13. Në vijim të kësaj dispozite kushtetuese, ligji nr. 84/2016, në nenin 52, pika 2, ka parashikuar se: “Nëse Komisioni ose Kolegji i Apelit arrin në përfundimin se provat kanë nivelin e provueshmërisë, sipas nenit 45, të këtij ligji, subjekti i rivlerësimit ka barrën e provës për të paraqitur prova ose shpjegime të tjera për të provuar të kundërtën”.
14. Në zbatim të normave *ut supra*, rezultateve të hetimit për të cilat subjektit i ka kaluar barra e provës, Komisioneri Publik çmon se shpjegimet dhe provat e paraqitura prej tij për të provuar të kundërtën, nuk janë të mjaftueshme për të rrëzuar rezultatet e hetimit. Si rrjedhojë, Komisioneri Publik vlerëson se konfirmimi i subjektit të rivlerësimit në detyrë nga ana e Komisionit nuk është i justifikuar dhe në pajtueshmëri me provat e administruara.
15. Bazuar në gjendjen që janë provat, subjekti i rivlerësimit nuk arrin të shpjegojë bindshëm burimin e ligjshëm të pasurisë së tij dhe personave të lidhur me të, si dhe gjendet në kushtet e deklarimit të pamjaftueshëm të pasurisë, në kuptim kjo të nenit D, pika 3 e aneksit të Kushtetutës dhe nenit 61, pika 3 e ligjit nr. 84/2016.
16. Gjithashtu pranë Institucionit të Komisionerëve Publikë, protokolluar me nr.*** datë ***.11.2018, nga ana e ONM-së është përcjellë një denoncim nga ana e publikut, i cili bazuar në nenin 53 të ligjit nr.84/2016, ndër të tjera parashtron fakte dhe rrethana të cilat meritojnë vëmendjen e Kolegjit, pasi nga hetimi dhe vlerësimi tërësor i tij, në varësi të rezultateve të hetimit mund të përbëjë shkak për vlerësimin edhe për dy kriteret e tjera, atë të figurës dhe aftësive profesionale të subjektit të rivlerësimit.
17. Sikurse kemi parashtruar edhe më sipër, në kushtet kur Komisioneri Publik është i detyruar që kompetencën e tij për të ushtruar ankim ndaj vendimeve të Komisionit, ta mbështesë vetëm në aktet dhe provat e administruara gjatë kryerjes së procesit të rivlerësimit nga ana e Komisionit, pa pasur mundësinë ai vetë (Komisioneri), që të ketë akses në burimet e informacionit dhe të disponojë për marrjen e provave, bazuar në nenin 179/b, pika 5 e Kushtetutës, nenit Ç të aneksit të Kushtetutës, nenit 4 dhe nenet 48 - 52 të ligjit nr. 84/2016, së bashku me këtë ankim, bashkëlidhim edhe denoncimin e ardhur nga publiku.
18. Sa më sipër, bazuar në nenin C, pika 2, nenin F, pikat 3 dhe 7, të aneksit të Kushtetutës si dhe nenit 4 dhe 66, të ligjit nr. 84/2016, Komisioneri Publik ankimon vendimin nr. 61, datë 2.8.2018 të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit.

II. A Vlerësimi i pasurisë

19. Si një ndër tri kriteret e procesit të rivlerësimit kalimtar, kontrollin dhe vlerësimin e pasurisë e gjejmë të rregulluar në nenin D të aneksit të Kushtetutës dhe nenet 30 - 33 të ligjit nr. 84/2016, ku realizimi i qëllimit të nenit 179/b, pika 1, të Kushtetutës, këto norma e konkretizojnë në identifikimin e subjekteve (i) që kanë në pronësi ose në përdorim pasuri

më të mëdha nga sa mund të justifikohen ligjërisht ose (ii) ata që nuk i kanë deklaruar saktësisht dhe plotësisht pasuritë e tyre dhe të personave të lidhur. Si rrjedhojë, subjekti i rivlerësimit ka detyrimin kushtetues për të shpjeguar bindshëm burimin e ligjshëm të pasurive dhe të të ardhurave, dhe nuk duhet të fshehë ose të paraqesë në mënyrë të pasaktë pasuritë në pronësi, posedim ose në përdorim të tij.

20. Në vështrim të sa më sipër, me qëllim përcaktimin e gjendjes së fakteve dhe rrethanave për vlerësimin e kriterit të pasurisë, hetimi administrativ nga organi rivlerësues nuk qëndron vetëm në kontrollin e deklaratës “Vetting”, pasi, referuar nenit 32/5, të ligjit nr. 84/2016, deklaratimet e mëparshme të pasurisë së subjektit të rivlerësimit përbëjnë provë dhe bazë krahasimi në vlerësimin⁶, nëse subjekti arrin nivel të besueshëm në vlerësimin e pasurisë apo gjenden shkaqe ligjore për shkarkimin e tij nga detyra.
21. Rezulton se subjekti i rivlerësimit, z. Gentjan Osmani, me funksion Magjistrat Prokuror prej tetorit të vitit 2003, është bërë subjekt deklarues i pasurisë pranë ILDKPKI-së, dhe ka deklaruar pasurinë me anë të deklaratave periodike për vitet 2004 - 2016, bazuar në ligjin nr. 9049/2003, “Për deklarimin dhe kontrollin e pasurive të detyrimeve financiare të të zgjedhurve dhe të disa nëpunësve publikë”, të ndryshuar, dhe ligjin nr. 9367/2005, “Për parandalimin e konfliktit të interesave në ushtrimin e funksioneve publike”, të ndryshuar.
22. Në zbatim të nenit D, pika 2 e aneksit të Kushtetutës, subjekti i rivlerësimit, më datë ***.1.2017, ka dorëzuar pranë ILDKPKI-së deklaratën e pasurisë “Vetting”, nga krahasimi i së cilës me deklaratat periodike të pasurisë, referuar nenit 32/5, të ligjit nr. 84/2016, ndër të tjera subjekti i rivlerësimit ka deklaruar:

22.1 **Pasuria 1**, apartament banimi me sip. 96 m², blerë për 82.000 euro, në janar të 2017.

Në deklaratën “Vetting” deklarohet: si pasuria me nr. ***, volumi ***, f.***, z. k. ***, e llojit apartament, me sip. 96 m² + 12 m² ambiente të përbashkëta, me adresë “****”...fituar me anë të kontratës së shitjes me nr. *** rep., nr. *** kol., datë ***.1.2017. Vlera, 82.000 euro. Në bashkëpronësi me bashkëshorten (50/50).

- Shpenzime të arredimit të pasurisë së sipërcituar, në vlerën 3.000.000 lekë, me burim nga kursimet e subjektit dhe bashkëshortes së tij, nga paga dhe shpërblime të tjera.

- **Burimi i krijimit** të pasurisë (shumës 82.000 euro), si llogari pranë “**** ****”, e krijuar nga shitja e pasurisë apartament me sip. 72 m² për vlerën 80.000 euro sipas kontratës nr. *** rep., nr. *** kol., datë ***.12.2016, si dhe derdhja e shumës prej 2.000 euro pranë kësaj llogarie bankare në datë ***.1.2017, me burim krijimi nga kursimet e subjektit dhe bashkëshortes.

- Në deklaratën “Vetting”, subjekti ka sqaruar dhe burimin e krijimit të apartamentit me sip. 72 m², sipërcituar, ku specifikon se kjo pasuri është fituar me anë të kontratës së shitblerjes nr. *** rep., nr. *** kol., datë ***.9.2016, porositur fillimisht me Aktmarrëveshjen nr. *** rep., datë ***.2.2009, për vlerën 67.680 euro. Nga kjo vlerë është paguar 63.680 euro, pasi diferenca prej 4.000 euro është zbritur si penalitet kontraktor për dorëzimin me vonesë të

⁶ Referuar edhe qëndrimin të Gjykatës Kushtetuese, mbajtur në vendimin nr. 2/2017, ku ndër të tjera shprehet se: “Komisioni heton në mënyrë të pavarur për të gjitha rrethanat e çështjes dhe kryen një proces të mirëfilltë kontrolli dhe vlerësimi, pa u bazuar dhe pa qenë i detyruar nga përfundimet e paraqitura nga ILDKPKI-ja”.

kësaj pasurie te subjekti. Me aplikimin nr. ***, datë ***.10.2016, pranë ZVRPP-së ***, ky apartament është rivlerësuar për shumën 80.000 euro (ose 11.200.000 lekë).

- **Si burim** i pagesës së shumës prej 63.680 euro/apartamenti me sip. 72 m² (shitja e të cilit ka shërbyer si burim krijimi për apartamentin me sip. 96 m²), subjekti ka deklaruar:

(i) të ardhurat nga paga në vite dhe shpërblime të tjera të subjektit dhe bashkëshortes;

(ii) një hua e shlyer tërësisht (20.000 euro); dhe

(iii) dhurimi nga prindërit e bashkëshortes në shumën 1.500.000 lekë.

Në deklaratën e vitit 2009, për pasurinë e mësipërme, subjekti ka deklaruar: apartament banimi me sip. 72 m², porositur me Aktmarrëveshjen nr. *** rep., datë ***.2.2009, në shumën 67.680 euro, nga të cilat paguar për vitin 2009, shuma 47.680 euro, për shkak të shtyrjes së punimeve.

- **Burimet e pagesës deri në ***.12.2009** janë: (i) të gjitha kursimet *cash* në vite së bashku me bashkëshorten; (ii) një pjesë e huas në shumën 20.000 euro⁷ (nga deklarimi rezulton të ketë paguar 5.000 euro, pasi 15.000 euro subjekti i deklaroi *cash*, si të mbetura nga kontrata e huas); (iii) të gjitha të ardhurat nga dhurimi për bashkëshorten, në shumën 1.500.000 lekë⁸.

- Në të njëjtën deklaratë, DV 2009, subjekti dhe personi i lidhur me të, bashkëshortja, kanë deklaruar:

(i) *Cash* në shumën 15.0000 euro, të mbetura nga kontrata e huas;

(ii) Kursime në *cash* për vitin 2009 në shumën 1.400.000 lekë nga paga dhe shpërblime të tjera nga marrëdhëniet e punës së subjektit dhe bashkëshortes;

(iii) E kursyer e ardhur në formën e dietave... në shumën 500 euro;

(iv) Dhurimi i prindërve të bashkëshortes... në shumën 1.500.000 lekë;

(v) Kursime *cash* në vite të bashkëshortes para lidhjes së martesës, nga marrëdhëniet e punës si gjyqtare... deri në vitin 2009, në shumën 550.000 lekë.

Në deklaratën e vitit 2011, subjekti deklaroi se ka shlyer nga huaja (prej 20.000 euro), shumën 7.000 euro.

Në deklaratën e vitit 2012, subjekti deklaroi se ka shlyer nga huaja shumën 5.000 euro.

Në deklaratën e vitit 2013, subjekti deklaroi se ka shlyer nga huaja shumën 8.000 euro.

Në deklaratën e vitit 2016, subjekti deklaroi: lidhjen e kontratës përfundimtare nr. *** rep., nr. *** kol., datë ***.9.2016, për blerjen e pasurisë... me sip. 72 m², porositur me Aktmarrëveshjen... në ***.2.2009, me vlerë 67.680 euro; Diferenca prej 4.000 euro është zbritur si penalitet kontraktor për dorëzimin me vonesë të pasurisë; Me aplikimin nr. ***, datë ***.10.2016, në ZVRPP, është bërë rivlerësimi i pasurisë në shumën 80.000 euro ose 11.200.000 lekë.

- Në të njëjtën deklaratë, DV 2016 (dorëzuar në mars të 2017), subjekti deklaroi shitjen e apartamentit me sip. 72 m², me kontratën nr. *** rep., nr. *** kol., datë ***.12.2016, në vlerën 80.000 euro.

⁷ Në rubrikën e “Detyrimeve financiare ndaj personave juridikë dhe fizikë” të DV 2009, subjekti deklaroi: “kontratë huaje pa afat, në formë shkresore, me qëllim blerjen e një apartamenti banimi, e lidhur në datë ***.8.2009, për marrjen e një huaje në shumën 20.000 euro, me një interes vjetor prej 5%”.

⁸ Personi i lidhur, bashkëshortja e subjektit ka deklaruar këtë shumë si dhurim të prindërve, si shkak i kontributit në familje.

23. Komisioneri Publik, pas analizimit tërësor të provave të administruara nga Komisioni, ato të dorëzuara nga subjekti me deklaratën “Vetting”⁹, shpjegimet dhe provat e administruara pas kalimit të barrës së provës ndaj subjektit, analizës financiare mbi verifikimin e gjendjes pasurore të deklaruar nga subjekti dhe personat e lidhur me të nga deklarimi i parë 2004 deri në deklaratën “Vetting” 2017, bazuar në kërkesat e nenit D të aneksit të Kushtetutës, nenit 30 dhe 32, pikat 1 dhe 4, të ligjit nr. 84/2016, çmon se subjekti i rivlerësimit dhe personat e lidhur/të tjerë të lidhur me të nuk arrijnë të justifikojnë bindshëm burimin e ligjshëm të pasurisë. Si rrjedhojë, subjekti i rivlerësimit gjendet në kushtet e deklarimit të pamjaftueshëm të pasurisë, referuar nenit 61/3, të ligjit nr. 84/2016. Gjithashtu, Komisioneri Publik vlerëson se provat dhe shpjegimet e paraqitura nga subjekti i rivlerësimit për të provuar të kundërtën e rezultateve të hetimit, bazuar në nenin 52/2, të ligjit nr. 84/2016, nuk janë të mjaftueshme për rrëzimin e këtyre rezultateve dhe justifikimin për konfirmimin në detyrë të tij, sikurse ka konkluduar Komisioni.
24. Në mbështetje të argumentit të mësipërm, për të vlerësuar nëse pasuria e subjektit të rivlerësimit dhe personat e lidhur/të tjerë të lidhur me të arrijnë të kalojnë “*testin e burimit të ligjshëm*”, si detyrim i nenit D/3 të aneksit të Kushtetutës, nenit 30 dhe 32/4, të ligjit nr. 84/2016, fokusi kryesor në vijim të këtij ankimi do të jetë burimi i krijimit të pasurisë/apartament me sip. 72 m² (65 m² + 7 m² ambiente të përbashkëta), shitja e të cilit ka shërbyer më pas si burim për pasurinë/apartament me sip. 96 m², aktualisht në pronësi të subjektit dhe bashkëshortes së tij, deklaruar në deklaratën “Vetting”.
25. Kështu, si burim krijimi për blerjen e apartamentit me sip. 72 m², në DV 2009, subjekti ka deklaruar: (i) të gjitha kursimet *cash* në vite së bashku me bashkëshorten; (ii) huan në shumën 20.000 euro; (iii) dhurimin nga prindërit e bashkëshortes, në shumën 1.500.000 lekë.
26. Në lidhje me huan. Referuar deklarimeve të subjektit të rivlerësimit rezulton se marrëdhënia e huas paraqitet e shtrirë në kohë prej gushtit të vitit 2009 dhe përfunduar, shlyer plotësisht, në vitin 2013. Kjo hua, përveç të ardhurave dhe kursimeve të subjektit të rivlerësimit dhe bashkëshortes së tij, ka shërbyer për pagimin e kësteve për blerjen e apartamentit ndaj shoqërisë ndërtuese “****” sh.p.k. Në këto kushte, hetimi administrativ i Komisionit është ndalur në tri elemente: (i) burimi i ligjshëm i huas, referuar nenit 32/1 dhe 32/4, të ligjit nr. 84/2016; (ii) mundësia financiare e subjektit për të paguar këstet për blerjen e apartamentit; si dhe (iii) mundësia financiare e subjektit të rivlerësimit për ta shlyer huan me të ardhura të ligjshme në tri këste, sikurse ka deklaruar për vitet 2011, 2012 dhe 2013, përkatësisht në shumën: 7.000 euro, 5.000 euro dhe 8.000 euro, së bashku me interesat e shlyer gjatë kësaj periudhe (2009 - 2013).
27. Mbi burimin e ligjshëm të huas
- 27.1 Nga hetimi administrativ i Komisionit ka rezultuar se subjekti i rivlerësimit nuk ka paraqitur asnjë dokument ligjor justifikues, i cili të vërtetojë dhe provojë marrëdhënien e huas, palët apo mënyrën e marrjes dhe shlyerjes së saj. Për këtë arsye, në përgjigje të pyetësorit të datës ***.4.2018, subjekti ka dhënë shpjegimin se huan e kishte marrë nga djali i dajës së tij, personi tjetër i lidhur, z. ****. ****, i cili jeton dhe punon në **** prej rreth 20

⁹ Referuar nenit 32/1, të ligjit nr. 84/2016 dhe udhëzimit nr. 4095 prot., datë 10.10.2016, të Inspektorit të Përgjithshëm të ILDKPKI-së.

vitesh, si dhe për shlyerjen e saj së bashku me interesat nuk është lëshuar ndonjë dokument, për shkak të marrëdhënieve të posaçme familjare që kanë.

27.2 Bazuar në nenin 32/4 të ligjit nr. 84/2016, subjektit të rivlerësimit i është kërkuar nga Komisioni të dokumentojë burimin e ligjshëm të të ardhurave të huadhënësit z. ***, në përgjigje të të cilit¹⁰, subjekti fillimisht ka paraqitur: dy kontrata pune të huadhënësit, datë ***.7.2002 dhe datë ***.2.2005, si dhe tri certifikata mbi të ardhurat e tij (huadhënësit), për vitet 2006, 2007 dhe 2008.

27.3 Duke qenë se dokumentet e mësipërme janë konsideruar të pamjaftueshme, Komisioni, në zbatim të nenit 52, pika 2, të ligjit nr. 84/2016, i ka kaluar barrën e provës subjektit për të dhënë argumente shoqëruar me provat shkresore, në lidhje me konstatimin mbi pamjaftueshmërinë e huadhënësit për të justifikuar shumën prej 20.000 euro.

27.4 Për të provuar të kundërtën e rezultateve të hetimit, subjekti ka paraqitur: Leje qëndrimi, lëshuar më datë ***.1.1999; Fletën e parë të pasaportës *** të huadhënësit me nr. ***; Certifikatën mbi të ardhurat e huadhënësit (***) për vitet 2002 - 2008.

27.5 Mbi bazën e akteve të mësipërme, trupi gjykues i Komisionit ka vlerësuar “*se ...nga viti 1999 e në vijim, nuk ndodhet në Shqipëri, duke qëndruar në ***. Në këtë shtet, ai ka realizuar të ardhura nga puna në shumën totale të 100.000 eurove. Në këto kushte, ai ka pasur mundësi për të kursyer shumën 20.000 euro, duke marrë në konsideratë dhe faktin se emigrantët nuk kanë një nivel të lartë jetese. Për sa më sipër, Komisioni krijon bindjen se z. ***, ka pasur të ardhura të mjaftueshme për të kursyer shumën 20.000 euro*”.

27.6 Komisioneri Publik, referuar të njëjtave akte mbi bazën e të cilave Komisioni ka arritur në vlerësimin e mësipërm, ndryshe nga Komisioni, çmon se subjekti i rivlerësimit dhe pas kalimit të barrës së provës, sërish nuk arrin të provojë të kundërtën për sa ka rezultuar nga hetimi administrativ.

27.7 Bazuar në deklaratat mbi të ardhurat e huadhënësit nga shteti *** (***), vërtetohet se të ardhurat e realizuara prej tij për vitet 2002 - 2008 janë në shumën totale prej 100.049 eurosh, por për vlerësimin e faktit nëse këto të ardhura janë të mjaftueshme për të kursyer shumën prej 20.000 euro, konstatojmë se Komisioni nuk ka marrë në konsideratë shpenzimet e jetesës së huadhënësit në shtetin *** apo shpenzimet/investimet që ai mund të ketë kryer gjatë këtyre viteve. Gjithashtu mungon informacioni mbi mënyrën e administrimit të këtyre kursimeve (20.000 euro), nëse janë administruar *cash* apo në llogari bankare dhe nëse ato janë sjellë në Shqipëri *cash* apo nëpërmjet kanalit bankar. Në mungesë të këtyre fakteve, dhe në referim të të dhënave zyrtare statistikore mbi nivelin e jetesës në shtetin ***, sipas të cilave të ardhurat e ligjshme të realizuara nga personi tjetër i lidhur ***. *** janë të mjaftueshme vetëm për mbulimin e nivelit minimal të shpenzimeve të jetesës së tij¹¹, Komisioneri Publik vlerëson se mbetet e paprovuar aftësia financiare e huadhënësit për kursimin dhe dhënien e shumës prej 20.000 euro, si dhe burimi i ligjshëm i saj.

27.8 Gjithashtu vlerësojmë se ka indicie të arsyeshme edhe mbi vërtetësinë e kësaj marrëdhënie huaje, pasi, veç faktit se shpjegimet e subjektit të rivlerësimit paraqiten kontradiktore mbi mënyrën e marrjes dhe shlyerjes së saj, konstatojmë se, megjithëse kjo marrëdhënie huaje është deklaruar prej vitit 2009, subjekti, me qëllim provueshmërinë dhe vërtetësinë e saj, ka paraqitur një shkresë të panoterizuar, e datës 21 gusht 2009, vetëm pas kalimit të barrës së provës gjatë procesit të rivlerësimit.

¹⁰ Referuar pyetësorit nr. *** të Komisionit.

¹¹ Referuar të dhënave zyrtare nga: www.istat.it.

27.9 Në konkluzion të sa më sipër, Komisioneri Publik vlerëson se në kuptim të nenit D, pika 3 e aneksit të Kushtetutës dhe nenit 32/4, subjekti i rivlerësimit dhe personi tjetër i lidhur me të, i deklaruar në cilësinë e huadhënësit, nuk arrijnë të vërtetojnë me anë të dokumentacionit justifikues ligjor burimin e të ardhurave që kanë shërbyer në blerjen e apartamentit me sip. 72 m² dhe pagesën e kësteve 1, 2 dhe 3¹², përkatësisht në shumat 15.000 euro në 31 janar 2009, 32.680 euro në 21 mars 2009 dhe 12.000 euro në 2010. Në këtë rast, detyrimi që rrjedh nga neni 32/4, i ligjit nr. 86/2014, duhet parë në funksion të plotësimit të dy elementeve, konfirmimi i kësaj marrëdhënie nga ana e personit tjetër të lidhur, me qëllim provueshmërinë dhe vërtetësinë e marrëdhënies, si dhe bashkëpërgjegjësia e personit tjetër të lidhur me subjektin e rivlerësimit për të justifikuar ligjshmërinë e burimit të krijimit të pasurive.

28. Vlen të theksohet se, edhe nëse e marrin të mirëqenë huan e dhënë nga personi tjetër i lidhur, ***, ***, rezulton se subjekti i rivlerësimit sërisht nuk mbulon me të ardhura të ligjshme pagesat për apartamentin dhe kursimet e vitit 2009, si dhe shlyerjet e deklaruara të huas në vitin 2011 - 2013.

28.1 Rezulton se Komisioni, me shkresën nr. *** prot., datë ***.1.2018, ka kërkuar pranë shoqërisë ndërtuese “****” sh.p.k. informacion të detajuar mbi mënyrën dhe kështet e shlyerjes së apartamentit të blerë nga z. Osmani, shoqëruar me dokumentacionin përkatës. Shoqëria ndërtuese në përgjigje të Komisionit, ka konfirmuar faktin se subjekti i rivlerësimit ka shlyer apartamentin sipas 6 mandatpagesave bashkëlidhur, duke sqaruar se është përjashtuar nga detyrimi shuma prej 4.000 euro, si penalitet i aplikuar ndaj shoqërisë për dorëzimin me vonesë të pasurisë. Referuar mandatpagesave, subjekti i rivlerësimit ka shlyer çmimin total prej 63.680 eurosh si më poshtë:

- i. Pagesë në arkën e shoqërisë 15.000 euro, datë ***.1.2009, sipas faturës nr. ***;
- ii. Pagesë në arkë 32.680 euro, datë ***.3.2009, sipas faturës nr. ***;
- iii. Pagesë në arkë 5.000 euro, datë ***.1.2010, sipas faturës nr. ***¹³;
- iv. Pagesë në arkë 3.000 euro, datë ***.5.2010, sipas faturës nr. ***;
- v. Pagesë në arkë 4.000 euro, datë ***.6.2010, sipas faturës nr. ***;
- vi. Pagesë në arkë 4.000 euro, datë ***.7.2010, sipas faturës nr. ***.

28.2 Sa më sipër provohet se për vitin 2009 subjekti ka paguar dy këste, përkatësisht 15.000 euro, më datë ***.1.2009 dhe 32.680 euro, më datë ***.3.2009. Pra, deri më datë ***.3.2009 subjekti ka paguar shumën totale prej 47.680 euro (ose 6.579.840 lekë).

28.3 Nga analiza financiare e Komisionit ka rezultuar se subjekti i rivlerësimit ka pasur mungesë burimesh financiare në shumën prej 1.043.092 lekë, për likuidimin e dy kësteve të apartamentit¹⁴.

28.4 Subjekti i rivlerësimit, pas kalimit të barrës së provës, ka sqaruar se: “1. Mandati i arkëtimit me nr. ***, datë ***.3.2009, është prerë në mënyrë të njëanshme nga përfaqësuesit e shoqërisë “****” sh.p.k., me qëllim për ta ndihmuar, për të kryer pagesat në çdo kohë në arkë (arkëtimin e shumës), pa qenë e nevojshme prania e përfaqësuesve të shoqërisë. Pra, mandati i arkëtimit në vlerën 32.680 euro nuk është paguar i plotë më datë ***.3.2009, pasi nga ana e tij nuk disponoheshin likuiditete të mjaftueshme në euro për pagesën e plotë. Pagesa e plotë është bërë deri në muajin dhjetor 2009.

¹² Referohu pikës 25.1 të ankimit.

¹³ Mandati, në fakt, daton ***.1.2009 dhe jo 2010.

¹⁴ Referohu f.12 të vendimit dhe rezultateve të hetimit administrativ në dosje të Komisionit.

28.5 Në mbështetje të këtij pretendimi, subjekti ka depozituar shkresën e shoqërisë “****” sh.p.k.¹⁵, e cila, në ndryshim nga sa i është përgjigjur Komisionit, në përgjigje të kërkesës së subjektit ka deklaruar se: *“Bazuar në marrëdhëniet e mirëbesimit që ne kemi ndërtuar me njëri-tjetrin në lidhjen e kësaj aktmarrëveshjeje, pamundësinë tuaj fizike për të qenë prezent gjatë orëve të punës së administratës së firmës sonë dhe duke pasur në konsideratë parashikimet kontraktore të kontratës ***.2.2009, nga ana e shoqërisë është lejuar faturimi i shumës në mandatin e arkëtimit nr. ***, prej 32.680 eurosh (kësti më i madh), të shkruhet e plotë, realisht nga ana Juaj kjo shumë është arkëtuar deri në fund të vitit 2009”*.

28.6 Sqarimet e subjektit janë konsideruar bindëse për Komisionin, pasi ka konkluduar *“se subjekti ka pasur burime të mjaftueshme për të shlyer këstet e këtij apartamenti për vitin 2009”*.

28.7 Sa më sipër rezulton se kemi prova kontradiktore mbi kohën dhe vlerat e paguara nga subjekti për këtë pasuri në vitin 2009, pasi shkresat e shoqërisë së ndërtimit të administruara nga Komisioni në cilësinë e provës kundërshtojnë njëra-tjetrën, ku nga njëra anë shoqëria pranon se ka arkëtuar shumën 32.680 euro, duke paraqitur për këtë qëllim mandatpagesën nr. ***, datë ***.3.2009, ndërkohë që në përgjigje të subjektit shprehet se kjo shumë nuk është shlyer në datë ***.3.2009, por është shlyer deri në fund të vitit 2009.

28.8 Komisioneri Publik vlerëson se argumentet që paraqet shoqëria në përgjigje të subjektit të rivlerësimit mbeten të nivelit deklarativ dhe nuk shërbejnë për të vërtetuar të kundërtën e rezultateve të hetimit, në kuptim kjo edhe të nenit 49/4, të ligjit nr. 84/2016. Këto argumente të shoqërisë së ndërtimit, nisur nga pretendimi mbi pamundësinë fizike të subjektit, i vlerësojmë si jo bindëse dhe nuk justifikojnë faktin se pse kjo shoqëri duhet të vërtetonte, nëpërmjet lëshimit dhe nënshkrimit të mandatpagesës nr. ***, datë ***.3.2009, shlyerjen e pagesës prej 32.680 eurosh nga ana e subjektit të rivlerësimit. Bazuar edhe në parimet bazë të kontabilitetit dhe vlerës provuese që paraqet mandatpagesa në këtë rast, si dokumenti që vërteton hyrjet e likuiditeteve në arkën e shoqërisë në kohë reale, me qëllim regjistrimin në librat kontabël, vlerësojmë se shoqëria mund të kishte vepruar në këtë mënyrë, duke provuar me anë të mandatpagesave përkatëse pretendimin se subjekti ka arkëtuar shumën jo në mars të 2009, por deri në fund të vitit 2009. Në këtë drejtim, me qëllim përcaktimin e gjendjes së fakteve dhe rrethanave të pretenduara, Komisioni, bazuar në nenin Ç, pika 4¹⁶, mund të shteronte hetimin administrativ të tij, duke kërkuar apo administruar dhe librat e llogarive të shoqërisë “****” sh.p.k., si dhe lëvizjet e llogarive bankare të kësaj shoqërie për këtë vit, duke konfirmuar deklaratimet e saj.

28.9 Nga analiza financiare e të ardhurave dhe shpenzimeve të subjektit të rivlerësimit deri në mars të vitit 2009, duke përfshirë dhe shumën prej 5.000 eurosh të huas së deklaruar prej tij si të përdorur për shlyerjen e kësteve, provohet se deri në këtë periudhë subjekti i rivlerësimit nuk ka pasur burime të ligjshme për mbulimin e kësteve të paguara, të paraqitura në formë tabelare si më poshtë:

¹⁵ Dokumentuar nga subjekti në përgjigje të rezultateve të hetimit, datë ***.7.2018

¹⁶ ...Komisioni ose Kolegji mund të urdhërojnë individë dhe shoqëri tregtare të dëshmojnë ose të japin prova në përputhje me ligjin.

Tabela nr. 1: Analiza e të ardhurave deri në mars të vitit 2009 (në lekë)

Gjendje <i>cash</i> i akumuluar, i deklaruar deri në ***.12.2008	2.950.000,00 ¹⁷
Të ardhura nga pagat janar - mars	400.898
Dhurim nga prindërit e bashkëshortes	1.500.000
Hua nga ***. ***	685.850 ¹⁸
Total i likuiditeteve në dispozicion	5.486.748
Shpenzime blerje apartamenti	6.577.933
Mbulimi	(1.041.185)

28.10 Mosmbulimi i pagesave të kësteve të apartamentit në vitin 2009 me burim të ligjshëm na rezulton si fakt, edhe nëse deklarimet e subjektit dhe shoqërisë “****” sh.p.k. i marrin të mirëqena. Nga analiza financiare e të ardhurave dhe shpenzimeve për të gjithë vitin 2009 rezulton se subjekti i rivlerësimi nuk mbulon me të ardhura të ligjshme kursimin e deklaruar dhe pagesat e kryera¹⁹.

28.11 Subjekti, në deklaratën vjetore të interesave privatë të vitit 2009, në f. 3, në seksionin ku kërkohet të përshkruhen hollësisht ndryshimet (shtesat dhe pakësime), për periudhën nga deklarimi i mëparshëm deri më 31 dhjetor të vitit të deklarimit, ka deklaruar gjithashtu dhe kursime nga pagat në *cash* shumën 1.400.000 lekë. Ndërkohë, në qëndrimet e tij lidhur me rezultatet e hetimit, subjekti sqaron se në total gjendja e likuiditeteve në datë ***.12.2009 ka qenë në shumën 364.642 lekë. Logjikisht, në mars të vitit 2010 (periudhë kur është plotësuar DV 2009) nuk mund të deklarohet një kursim në *cash*, i cili është shpenzuar respektivisht në korrik dhe dhjetor të vitit 2009²⁰.

28.12 Në konkluzion të sa më sipër, bazuar në analizën e të ardhurave dhe shpenzimeve të vitit 2009, rezulton se subjekti nuk mbulon me të ardhura të ligjshme kursimin dhe shpenzimet e deklaruara gjatë këtij viti, në shumën totale prej 764.483,44 lekë, paraqitur në formë tabelare si më poshtë:

Tabela nr. 2. Analizë financiare viti 2009 (në lekë)

Likuiditete të akumuluar deri në datë ***.12.2008	2.900.897 ²¹
Të ardhura nga paga vjetore	1.993.999
Dhurim nga prindërit e bashkëshortes	1.500.000
Hua nga ***. ***	2.759.200 ²²
Total likuiditete në dispozicion	9.203.199
Shpenzime minimale jetese	321.428
Shpenzime blerje apartamenti	6.577.933 ²³
Shpenzime udhëtimi	96.019 ²⁴
Kursime në fund të vitit	1.409.748 ²⁵
Likuiditete <i>cash</i> të mbetura nga huaja	2.069.400
Total shpenzime + kursime	9.908.831
Mbulimi i shpenzimeve me të ardhura të ligjshme	(764.483,44)

¹⁷ Nga të cilat 2.400.000 lekë *cash* i akumuluar nga subjekti dhe 500.000 lekë nga bashkëshortja.

¹⁸ Pjesa 5.000 euro e deklaruar nga subjekti, e përdorur nga huaja 20.000 euro. Kjo shumë i merret në llogaritje bazuar vetëm në deklarimet e tij, pasi nga dokumentacioni i paraqitur kontrata rezulton e hartuar në gusht 2009.

¹⁹ Referohu tabelës nr. 4.

²⁰ Sipas sqarimeve të subjektit, gjatë qëndrimit të tij mbi rezultatet e hetimit paraprak. Gjithashtu, deklarimi i subjektit se shpenzimet për këtë periudhë kanë qenë më minimale se ato të llogaritura, nuk qëndron dhe është i pambështetur.

²¹ 2.400.000 subjekti *cash*, i akumuluar ndër vite sipas deklaratave vjetore, 500.000 bashkëshortja dhe gjendja në llogarinë bankare, datë ***.12.2008.

²² Kundërvlera e 20.000 euro me kurs mesatar vjetor të vitit 2009, sipas të dhënave të Bankës së Shqipërisë.

²³ Kundërvlera e 47.680 euro e konvertuar me kursin e datës 30.1.2009, sipas deklarimit të subjektit në qëndrimin e tij lidhur me rezultatet e hetimit.

²⁴ Shpenzimet e udhëtimit janë llogaritur sipas deklarimeve të subjektit, por nuk rezulton të jenë paraqitur dokumente justifikuese mbi mbulimin e shpenzimeve nga institucioni pritës.

²⁵ 1.400.000 lekë në *cash* sipas deklaratave vjetore dhe 9.748 likuiditete në llogaritë bankare të subjektit dhe bashkëshortes.

29. Mbi mundësinë financiare të subjektit të rivlerësimit për të shlyer huan me të ardhura të ligjshme në vitet 2011 - 2013

29.1 Nga analiza financiare e Komisionit ka rezultuar se për vitet 2011, 2012 dhe 2013, vite në të cilat subjekti ka deklaruar shlyerjen e huas, përkatësisht në vlerat 7.000 euro, 5.000 euro dhe 8.000 euro, subjekti nuk ka pasur të ardhura të ligjshme në shumën totale prej 2.498.919 lekë, fakt për të cilin i ka kaluar barra e provës.

29.2 Për të provuar të kundërtën, subjekti së bashku me shpjegimet, ka paraqitur dhe analizën e tij financiare, ku ndër të tjera ka sqaruar se: *“Fillimisht në deklaratimet e mia dhe të bashkëshortes, kur është deklaruar fjala ‘cash’, është nënkuptuar fjala likuiditet/kursim në lekë nga të ardhurat e vitit, qoftë brenda apo jashtë sistemit bankar. Për këtë arsye, shuma e deklaruar cash në deklaratimet e çdo viti nënkupton likuiditetet brenda dhe jashtë sistemit bankar. Si rrjedhojë, likuiditetet në banka nuk duhet t’i shtohen shumës së deklaruar, por janë pjesë e saj...”²⁶”.*

29.3 Në përfundim, Komisioni ka konkluduar se *subjekti i rivlerësimit ka pasur burime të mjaftueshme për të shlyer huan në shumën 20.000 euro.*

29.4 Komisioneri Publik, ndryshe nga përfundimi i mësipërm i Komisionit, vlerëson se subjekti i rivlerësimit nuk ka arritur të provojë të kundërtën e rezultateve të hetimit. Konstatohet se Komisioni, duke mos vlerësuar drejt rrethanat dhe faktet e paraqitura nga subjekti, i ka marrë të mirëqena pretendimet e tij, megjithëse metodologjia e përdorur nga subjekti vjen në kundërshtim logjik me vetë deklaratimet periodike, ndër vite, të tij. Provat dhe argumentet e dhëna nga subjekti vetëm pas njoftimit për rezultatin e hetimeve dhe kalimit të barrës së provës nuk i vlerësojmë të mjaftueshme për të hedhur poshtë rezultatet e hetimit.

29.5 Rezulton se subjekti ka deklaruar ndër vite rregullisht kursimet në *cash*, në f. 3 të deklaratave vjetore, në të cilën kërkohet të specifikohen shtesat dhe pakësimet në pasuri të paluajtshme dhe të luajtshme nga 31 dhjetori i vitit paraardhës deri në 31 dhjetor të vitit të deklaratimit. Për çdo vit, subjekti i është referuar kursimit të deklaruar si kurse nga paga dhe shpërblime të tjera nga marrëdhëniet e punës, në *cash* për vitin respektiv. Subjekti, me përjashtim të vitit 2009, kur blihet pasuria apartament me sip. 72 m², nuk ka deklaruar në deklaratat vjetore pakësime në kursimet e deklaruara në vitet e mëparshme.

29.6 Argumentimi që përdor subjekti në qëndrimet e tij ndaj rezultateve të hetimit, lidhur me faktin se kur deklarohet *“cash”*, nënkupton fjalën likuiditet/kursim... brenda dhe jashtë sistemit bankar, nuk qëndron. Komisioneri Publik, në konsideratë edhe të formimit profesional të subjektit, për të cilin nuk mund të vihet në diskutim kuptimi i fjalës *“cash”*, sjell në vëmendje pikën II/12 të parashtrimeve të tij, ku ndër të tjera për dhurimin e shumës 1.500.000 lekë nga prindërit e bashkëshortes, shprehet se... *“shumë e cila...ka kaluar në formën e dhurimit, në dorë ose sipas gjuhës ekonomike ‘cash’, që posedohej në këtë mënyrë nga ana e tyre”*.

29.7 Ligji nr. 9049/2003, i ndryshuar, në nenin 21, përcakton qartë se: *“...deklarimi i pasurive, i burimeve të tyre, i detyrimeve financiare bëhet sipas kërkesave të përcaktuara në këtë ligj dhe në formën e përcaktuar nga Inspektori i Përgjithshëm...”*. Formularët e deklaratimit të interesave vjetorë, miratuar nga Inspektori i Përgjithshëm, për vitet në të cilat subjekti argumenton mungesën e burimit të të ardhurave të ligjshme për të mbuluar

²⁶ Referohu përgjigjes nr. ***, datë ***.7.2018, të subjektit të rivlerësimit në dosje të Komisionit.

shpenzimet/kursimet e tij, përcakton qartazi se çfarë përfshihet në pasuritë e luajtshme, duke bërë në mënyrë të kuptueshme diferencën mes gjendjes *cash* dhe likuiditeteve në bankë.

29.8 Po ashtu, ky ligj në nenin 4, “Afati dhe objekti i deklarimit”, germa “d” e tij, ka të shprehur qartë objektin e deklarimit, në të cilën është më se e kuptueshme se çfarë përfshihet në deklarimet *cash*. Pikërisht ky përcaktim i këtij ligji dhe ndryshimet e pësuar më pas, saktësojnë diferencimin e objektit të deklarimit lidhur me gjendjen *cash*, jashtë sistemit bankar dhe likuiditeteve në bankë, depozita, në bono etj.²⁷. Në analizën që subjekti ka vënë në dispozicion, mbi perceptimin e konceptit të parave *cash*, rezulton se për disa vite, shuma e parave në *cash* të poseduara deklarohet në shuma të cilat, për nga natyra dhe për nga prerja zyrtare e monedhave, janë të pamundura për t’u disponuar fizikisht²⁸.

29.9 Konstatohet gjithashtu se subjekti, në analizën financiare të paraqitur në përgjigje të rezultateve të hetimit administrativ, ka paraqitur fakte të ndryshme nga çfarë ka deklaruar në deklaratat periodike vjetore. Për disa vite, subjekti në qëndrimet e tij ka deklaruar se kursimi i deklaruar në fund të vitit në deklaratën periodike, në seksionin ku kërkohet të deklarohen shtesat apo pakësimet e pasurive, nuk është kursimi real i poseduar në fund të vitit të deklarimit, por në të janë përfshirë dhe pagesa të kryera gjatë vitit.

26.10 Këto mospërputhje të subjektit në deklarimet periodike vjetore dhe argumentimi i diferencave vetëm gjatë procesit të hetimit administrativ, vlerësojmë se kanë për qëllim justifikimin e diferencave të konstatuara nga Komisioni në mbulimin e pasurive me të ardhura të ligjshme dhe nuk mund të shërbejnë për të provuar të kundërtën e rezultateve të hetimit.

26.11 Në konkluzion të sa më sipër, Komisioneri Publik vlerëson se subjekti i rivlerësimit nuk ka pasur të ardhura të ligjshme të mjaftueshme për të mbuluar pagesat për blerjen e apartamentit dhe shlyerjen e huas së bashku me interesat ndaj personit tjetër të lidhur ***.***., për vitet 2011 - 2012 - 2013, të cilat në mënyrë të përmbledhur paraqiten në tabelën e mëposhtme:

Tabela nr. 3. Mosmbulimi me të ardhura të ligjshme i shlyerjes së huas 20.000 euro

	2011	2012	2013
	(në lekë)	(në lekë)	(në lekë)
Likuiditete në llog. bankare në fillim të vitit	11.013	416.166	10.110
Likuiditete në <i>cash</i> nga kursimet e vitit të mëparshëm	1.190.00,0 ²⁹	1.690.000	2.450.000
Likuiditete në <i>cash</i> mbetur nga huaja	486.255	0	0
Total likuiditete në dispozicion (I)	1.686.708	2.106.306	2.460.110
Të ardhura SR	1.240.118	1.198.149	1.263.604
Të ardhura bashkëshortja	636.177	584.061	832.157
Totali i të ardhurave³⁰ (II)	1.876.295	1.782.210	2.095.761
Shpenzime minimale jetese	482.143	482.143	642.857
Pagese kësti për apartamentin	555.720 ³¹	0	0
Shlyerje huaje	972.510 ³²	697.950 ³³	1.121.600 ³⁴
Shpenzime për rinovimin e shtëpisë	700.000	0	0

²⁷ Referohu ndryshimeve ligjore që ka pësuar kjo dispozitë dhe në vitin 2014.

²⁸ Në analizën e vitit 2006, subjekti sqaron se kursimet në *cash* kanë qenë në vlerën 454.011 lekë. Në analizën e vitit 2007 sqaron se kursimet në *cash* kanë qenë në vlerën 499.926 lekë. Në analizën e vitit 2008 sqaron se kursimet në *cash* kanë qenë në vlerën 699.676 lekë dhe, po për këtë vit, deklaroi si kursime të bashkëshortes vlerën 499.426,13 lekë. Në analizën e vitit 2010 sqaron se kursimet në *cash* kanë qenë në vlerën 943.990,15 lekë. Në analizën e vitit 2011 sqaron se kursimet në *cash* kanë qenë në vlerën 88.837,49 lekë. Në analizën e vitit 2012 sqaron se kursimet në *cash* kanë qenë në vlerën 989.894 lekë.

²⁹ 950.000 lekë kursim nga pagat dhe 240.000 lekë kursim nga shitja e automjetit.

³⁰ Sipas vërtetimeve nga institucionet përgjegjëse.

³¹ Kundërvlera e 4.000 euro me kurs mesatar të BSH-së.

³² Kundërvlera 7.000 euro, deklaruar shlyer huaja me kurs mesatar të BSH-së.

³³ Kundërvlera e 5.000 euro, deklaruar shlyer huaja me kurs mesatar të BSH-së.

³⁴ Kundërvlera e 8.000 euro, deklaruar shlyer huaja me kurs mesatar të BSH-së.

Shpenzime udhëtimi sipas TIMS	4.168	83.754	14.020
Totali i shpenzimeve (III)	2.714.541	1.263.847	1.778.477
Likuiditete <i>cash</i> në fund të vitit (IV)	1.690.000 ³⁵	2.690.000 ³⁶	3.900.000 ³⁷
Gjendje në llog. bankare në fund të vitit (V)	416.166	10.110	27.468
Total likuiditete, gjendje në fund të vitit	2.106.306	2.700.110	3.927.468
Diferenca për mbulimin e shpenzimeve³⁸ (VI=I+II-III-I-IV)	(1.257.844)	(75.441)	(1.150.074)

30. Në lidhje me shumën e dhuruar prej 1.500.000 lekë

Sikurse kemi parashtruar edhe më sipër, në deklaratën e vitit 2009, subjekti, ndër të tjera, ka deklaruar si burim për blerjen e apartamentit të banimit me sip. 72 m²: *“të gjitha të ardhurat nga dhurimi i prindërve, për bashkëshorten, në shumën 1.500.000 lekë, por në fashikullin e Komisionit nuk rezultojnë të jetë administruar ndonjë akt për dokumentimin dhe provueshmërinë e këtij dhurimi.*

30.1 Komisioni i ka kaluar subjektit barrën e provës, duke i kërkuar të vërtetojë burimin e ligjshëm të shumës 1.500.000, mënyrën e posedimit, si dhe mënyrën e kalimit të kësaj shume te subjekti apo bashkëshortja e tij.

30.2 Subjekti, në përgjigje të rezultateve të hetimit, ka paraqitur argumentet e tij, duke i shoqëruar dhe me një analizë financiare për vitet që bashkëshortja ka jetuar me prindërit e saj. Subjekti ka argumentuar se bashkëshortja të ardhurat e fituara nga puna e saj, gjatë kohës së bashkëjetesës me prindërit, i ka kaluar të gjitha në ekonominë e përbashkët familjare dhe për këtë arsye nuk ka deklaruar asnjë kursim nga ato, në deklaratimet e saj periodike.

30.3 Nisur nga përmbajtja e vendimit, Komisioni, pasi ka kryer analizën financiare mbi të ardhurat e familjes së bashkëshortes së subjektit, ka konkluduar se personat e tjerë të lidhur, familjarët e saj kanë pasur të ardhura të ligjshme për të dhuruar shumën 1.500.000 lekë³⁹.

30.4 Komisioneri Publik, ndryshe nga përfundimi i arritur prej Komisionit, konstaton se dokumentacioni i paraqitur nga subjekti nuk sjell ndonjë ndryshim lidhur me rezultatet e hetimit administrativ, si rrjedhojë subjekti nuk ka arritur të provojë të kundërtën për sa i është kaluar barra e provës.

30.5 Rezulton se bashkëshortja e subjektit të rivlerësimit është subjekt deklarimi pasurie pranë ILDKPKI-së prej vitit 2005, në cilësinë si magjistrate gjyqtare. Nga verifikimi i deklaratave vjetore të personit të lidhur/bashkëshortes së subjektit të rivlerësimit dhe vërtetimeve nga institucionet përgjegjëse, të ardhurat e saj janë në shumën totale prej 3.788.682 lekë.

30.6 Në analizë të të ardhurave të bashkëshortes së subjektit dhe prindërve të saj për periudhën 2004 - 2008⁴⁰, mbështetur edhe në informacionin e vënë në dispozicion nga subjekti, rezultojnë se personat e tjerë të lidhur, prindërit e bashkëshortes së subjektit nuk kanë

³⁵ Kursimi i vitit të mëparshëm plus 500.000 lekë të vitit 2011. Subjekti në f. 3 të DV 2011, në seksionin shtesa/pakësime, deklaroi kursime nga paga e tij dhe e bashkëshortes në *cash për vitin 2011 në shumën 500.000 lekë.*

³⁶ 1.690.000 të vitit të mëparshëm dhe 1.000.000 të vitit 2012. Subjekti në f. 3 të DV 2012, në seksionin shtesa/pakësime, deklaroi kursime nga paga e tij dhe e bashkëshortes në *cash për vitin 2012 në shumën 1.000.000 lekë.*

³⁷ 2.450.000 lekë kursime të vitit të mëparshëm dhe 1.450.000 lekë kursime të vitit 2013. Subjekti në f. 3 të DV 2013, në seksionin shtesa/pakësime, deklaroi kursime nga paga e tij dhe e bashkëshortes në *cash për vitin 2013 në shumën 1.450.000 lekë.*

³⁸ Në analizë nuk është përfshirë shlyerja e interesave të huas në shumën 1.000 euro (me interes 5% sipas kontratës), e cila është deklaruar nga subjekti si e shlyer gjatë periudhës 2009 - 2013, por nuk është deklaruar bashkë me shumën e shlyera të huas.

³⁹ Referohu f. 9 të vendimit të Komisionit.

⁴⁰ Referohu tabelës nr. 4.

pasur të ardhura të mjaftueshme për të mbuluar shumën e deklaruar si të dhuruar⁴¹. Teprica e mbetur nga të ardhurat familjare, pasi zbriten shpenzimet minimale të jetesës, është e pamjaftueshme për mbulimin e shumës së dhuruar.

30.7 Sa më sipër, veç faktit se dhurimi nuk rezulton të jetë konfirmuar dhe provuar si fakt i pretenduar, mbetet i pajustificuar ligjshmëria e burimit të krijimit të kësaj shume të dhuruar.

Tabela nr. 4 Analizë financiare mbi familjen ***, vitet 2004 – 2008 (në lekë)

Të ardhura b/sh 2004-2008	3.788.682
Të ardhura babai i b/sh ⁴²	471.899
Shpenzime minimale konsumi familjar për një familje me 3 persona 2004 - 2008	2.500.000
Kursime personale, bashkëshortja, deklaruar në DV 2008	500.000
Diferenca e mbetur për tu kursyer	1.260.581

31. Pasuria e luajtshme, automjet tip “****”

31.1 Në deklaratën e interesave privatë të vitit 2009, subjekti i rivlerësimit ka deklaruar gjithashtu edhe një automjet të tipit “****”, blerë në datë ***.7.2005, për vlerën 450.000 lekë, *cash*, si kursime nga marrëdhëniet e punës dhe shpërblime të tjera.

31.2 Në deklaratën e interesave privatë të vitit 2005, nuk rezulton i deklaruar ky aset, fakt për të cilin Komisioni e ka pyetur subjektin mbi arsyet e mosdeklarimit.

31.3 Subjekti, në përgjigje të pyetësorit të datës ***.4.2018⁴³, sqaron ndër të tjera se është menduar si e deklaruar në vitin 2005, por që është konstatuar gjatë deklarimeve të interesave privatë të vitit 2009, në kohën kur ka bërë deklaratimet së bashku me bashkëshorten për pasuritë e disponuara veçmas. Gjithashtu, subjekti shprehet se, për sa i përket aktit të blerjes, nuk disponohet nga ana e tij, për shkak se i ka humbur. Edhe deklarimi i bërë në vitin 2009 është bërë duke u bazuar në mënyrë të përafërt.

31.4 Komisionit, pas analizës lidhur me mundësinë financiare për blerjen e këtij automjeti, i ka rezultuar se subjekti i rivlerësimit nuk ka pasur të ardhura të mjaftueshme, fakt për të cilin i ka kaluar barrën e provës.

31.5 Subjekti i rivlerësimit, në përgjigje të rezultateve të hetimit administrativ⁴⁴, ka sqaruar se: “Automjet tip ‘****’, në vlerën 450.000 lekë, fituar me kontratën e shitblerjes, datë ***.7.2005, nuk është blerë me kursimet nga paga e vitit 2005, por nga likuiditetet që ai kishte nga kursimet e vitit 2004, pra nga shuma 750.000 lekë. Nga kjo shumë kanë mbetur likuiditete nga të ardhurat e vitit 2004 në vlerën 750.000 - 450.000 - 300.000 lekë. Likuiditetet e krijuara dhe të deklaruara në shumën 400.000 lekë për vitin 2005 u përkasin të ardhurave të vitit 2005, pra shumës 814.949 lekë, së cilës i janë zbritur shpenzimet për jetese dhe të tjera. ... Përfundimisht, pasuria e mbartur për vitin 2006 apo deri më datë ***.12.2005 përbëhet nga: Likuiditete në masën 700.000 lekë; Pasuri e luajtshme (makinë) në vlerën 450.000 lekë”.

31.6 Komisioni i ka konsideruar bindëse sqarimet e mësipërme të subjektit dhe në përfundim ka konkluduar se ai ka pasur burime të mjaftueshme për blerjen e automjetit.

41 Në ndryshim nga Komisioni, mbështetur në të dhënat zyrtare nga INSTAT, na rezulton se shuma e llogaritur prej 1.754.19641 lekë, si shpenzime jetese për periudhën 2004 - 2008, është më e vogël se standardi i publikuar nga INSTAT dhe vetë standardi i përdorur nga Komisioni gjatë analizës financiare të subjektit të rivlerësimit.

42 Sipas lëvizjeve nga llogaria bankare pranë BKT-së, për periudhën shtator 2007 - dhjetor 2008, si i vetmi informacion i disponuar mbi të ardhurat e ligjshme mujore të prindërve të bashkëshortes së subjektit.

43 Referohu fashikullit “pyetësorët”, në dosje të Komisionit.

44 Referohu përgjigjes në dosje të Komisionit, f.*** të parashtrimeve të subjektit.

31.7 Komisioneri Publik vlerëson se deklarimi i subjektit në analizën financiare të paraqitur për efekt mbulimi të shpenzimeve me të ardhura të ligjshme, nuk përputhet me deklarin vjetor të tij për vitin 2005, sipas së cilit, në faqen nr. 3 të formularit, ku kërkohet të deklarohet: *Përshkrim i hollësishëm i shtesave dhe pakësimeve në çdo lloj pasurie të paluajtshme dhe të luajtshme...* subjekti ka deklaruar: gjendje *cash* 400.000 lekë, dhe nuk rezulton të ketë deklaruar pakësime të likuiditeteve të mëparshme.

31.8 Në ndryshim nga Komisioni, bazuar në deklaratimet vjetore të subjektit të rivlerësimit, konstatojmë se ai nuk ka pasur të ardhura të ligjshme të mjaftueshme për të mbuluar kursimet dhe shpenzimin e kryer në vitin 2005 për blerjen e automjetit.

31.9 Sa më sipër analizuar, rezulton se për këtë pasuri subjekti ka kryer deklarin të pamjaftueshëm dhe nuk mbulon me të ardhura të ligjshme realizimin e kursimeve dhe blerjen e këtij aseti, paraqitur në formë tabelare si më poshtë:

Tabela nr. 5 Analizë financiare viti 2005 (në lekë)

Likuiditete <i>cash</i> në fillim të vitit 2005	750.000
Likuiditete në llogarinë bankare në fillim të vitit 2005	12.490
Total likuiditete në fillim të vitit	762.490
Të ardhura nga paga SR	814.949
Shpenzime minimale jetese	160.714
Shpenzime blerje automjeti	450.000
Shpenzime udhëtimi sipas TIMS	52.692
Total shpenzime	663.406
Gjendje likuiditete në fund të vitit <i>cash</i>	1.150.000 ⁴⁵
Gjendje në llog. bankare në fund të vitit	(206)
Mbulimi i shpenzimeve me të ardhura të ligjshme	(235,761.17)

32. Kërkimi i ankimit

32.1 Nisur nga parashikimi i nenit 179/b/5 të Kushtetutës, nenit C/2, Ç, D dhe F/7, të aneksit të Kushtetutës, konsiderojmë se, ndryshe nga sa ka konkluduar Komisioni i Pavarur i Kualifikimit, referuar gjendjes së fakteve dhe provave, Komisioneri Publik nuk krijon bindjen se subjekti i rivlerësimit ka arritur të shpjegojë bindshëm burimin e ligjshëm të pasurive dhe të ardhurave të tij, me qëllim arritjen nivelit të besueshëm në vlerësimin e pasurisë, sipas nenit 59/1 të ligjit nr. 84/2016;

32.2 Shkaqet përcaktuese për të cilat Komisioneri Publik çmon se ky vendim i Komisionit nuk është i drejtë, qëndrojnë në vlerësimin se: (i) nuk provohet dhe vërtetohet ekzistenca e marrëdhënies së huas, si dhe mundësia financiare e personit tjetër të lidhur për të dhënë hua shumën 20.000 euro; (ii) nuk provohet dhe vërtetohet dhurimi në shumën prej 1.500.000 lekë, si dhe mundësia financiare e personave të tjerë të lidhur për të dhënë këtë shumë, si rrjedhim, subjekti nuk mbulon me të ardhura të ligjshme shlyerjen e kësteve të apartamentit të blerë në 2009; (iii) edhe nëse huan dhe dhurimin i konsiderojmë në mesin e burimeve të ligjshme, nga analiza financiare rezulton se subjekti i rivlerësimit ka mungesë burimesh të ligjshme për shpenzimet dhe kursimet e deklaruara për vitet 2005 - 2013 (ku përfshihet edhe shlyerja e huas), në shumën totale prej 3.760.305 lekë. Subjekti i rivlerësimit gjendet në kushtet e deklarin të pamjaftueshëm për kontrollin e pasurisë, referuar nenit 61, pika 3 e ligjit nr. 84/2016;

⁴⁵ 750.000 të vitit 2004 dhe 400.000 lekë kursime të vitit 2005, sipas deklaratës vjetore të vitit 2005.

32.3 Duke ritheksuar se Komisioneri Publik ka detyrimin që të ushtrojë kontroll mbi vendimet e dhëna nga Komisioni, me qëllim që të garantojë mbrojtjen e interesit publik në procesin e rivlerësimit, duke vlerësuar në qoftë se vendimmarrja e Komisionit për konfirmimin ose shkarkimin e subjektit, ose ndërprerjen e procesit të rivlerësimit është marrë në përputhje me ligjin, në përfundim të një hetimi të plotë, mbështetur në faktet dhe provat e administruara për këtë qëllim;

32.4 Nisur nga fakti se Komisioneri Publik është i detyruar që kompetencën e tij për të ushtruar ankim ndaj vendimeve të Komisionit ta mbështesë vetëm në aktet dhe provat e administruara gjatë kryerjes së procesit të rivlerësimit nga ana e Komisionit, pa pasur mundësinë ai vetë, Komisioneri Publik, që të ketë akses në burimet e informacionit dhe të disponojë për marrjen e provave;

32.5 Bazuar në nenin D, DH, E dhe F të aneksit të Kushtetutës, nenet 30 - 34, nenit 53 dhe nenit 61 të ligjit nr. 84/2016;

32.6 Kërkojmë që shkaqet e këtij ankimi së bashku me denoncimin nga publiku të merren në shqyrtim nga ana e Kolegjit të Posaçëm të Apelimit dhe, në zbatim të nenit 66, të ligjit nr. 84/2016, të vendosë:

- Ndryshimin e vendimit nr. 61, datë 2.8.2018, të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, dhe shkarkimin nga detyra të subjektit të rivlerësimit, z. Gentjan Osmani.

KOMISIONERI PUBLIK

Darjel SINA